



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Sh.II.nr.1309/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përbarimore të kreditorit N.T.P. E... nga Prishtina kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.242/2017 date 02.07.2018, jashtë seancës me datë 22.08.2022, mori këtë:

### AKTVENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.242/2017 të dt.02.07.2018, VËRTETOHET.

### Arsyetim

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar , PPP.nr.242/2017 të dt.02.07.2018, ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit, Komuna e Prishtinës, të paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.47/17 dt.06.03.2017 të Përbaruesit Privat Gjakë Radi nga Gjakova

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.242/2017 të dt.02.07.2018 kurse lënda ti kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë apo që kjo gjykatë të vendos në mënyrë meritore,

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se Përbaruesi privat me Urdhër Përbarimor, P.nr.47/17 dt.06.03.2017, e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me nr..... i datës 14.02.2017 në vlerë prej 3.674.00 euro, së bashku me shpenzimet e procedurës, për mos përmbushje të detyrimeve ndaj kreditorit.

Kundër Urdhrit për Përmbarrim, debitori ka ushtruar prapësim me datë 06.03.2017, duke theksuar që urdhri i caktuar nga ana e Përmbarruesit Privat është i pa bazuar pasi që fatura ë prezantuar është e papranuar, mirëpo është fakt i pa kontestueshëm që debitorit ka lidhur kontratë për furnizimi me pajisje për kabinet të fizikës kimisë biologjisë me dt.04.08.2014 për shkollat e mesme, e cila është zbatuar në tërsi, mirëpo fatura nuk ka bazë ligjore për shkak se nuk është miratuar nga zyra e prokurimit meqë rast kreditori ka bërë shkelje të kontratës, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhëri përmbarrimor.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke theksuar se në pretendimet në prapësim ka pasaktësi sepse realizimi i projektit nuk është bërë në tërsi siq thuhet në prapësim, Nga kontrata me debitorin për furnizim me pajisje shkollore kanë mbetur pa u realizuar shuma prej 3,674.00€ andaj ka propozuar që të vazhdohet me urdhërin përmbarrimor.

Gjykata e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të prapësimit si dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.242/2017 të dt. 02.07.2018, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit, me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar se urdhëri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat bazohet në faturat e kreditorit nr..... dt.14.02.2017 e cila është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit (e-mail dt.23.02.2017), andaj urdhëri përmbarrimor i lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm faturës nr.... dt.14.02.2017 përbën bazën juridike për caktimin e përmbarrimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 24 dhe 27 të LPP-së për të qenë i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftuara, bindëse, faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare, kështu që mund të hetohet dhe të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata përmbarrimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale, aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka si në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarrimore, përkatësisht neni 29 par 1. nën par.1.3 dhe par 3. I cili përcakton se: “ *Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: fatura. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbarrimit të detyrimit monetar* ”. Gjithashtu neni 37 dhe 40 par.1 pika 3 i LPP-së, përcakton se propozimi për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë “ *origjinalin apo kopjen e vërtetuar e dokumentit të besueshëm* ” e në rastin konkret fatura, kontrata, po ashtu edhe propozimi i përmbajnë të gjitha

elementet e kërkuara nga dispozitat e lartpërmendura, andaj si i tillë dokumenti i besueshëm përmban tiparet e nevojshme të përmbarueshmërisë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Debitori në prapësim nuk ka ofruar ndonjë argument apo provë me të cilën kishte me paraqitur ndonjë nga shkaqet që janë të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Duke u mbështetur në nenin 69 par.4 të LPP *“baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim.

Duke marr parasysh pretendimet tjera ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lejuar urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr. 47/17 i dt.06.03.2017

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom,Dh.Shk.II nr.1309/22 me datën 22.08.2022

Gjyqtari  
Krenar Berisha